



01-2378

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës kërkesën 05 Nr.350/02-169159/24 dt.24.12.2024, të bashkëpronarëve, Xhevdet Krasniqi dhe Shqipe Jashari Krasniqi nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore/shtëpisë familjare me etazhitet B+P+1, në kuadër të bllokut urban “F-03”, të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 09.06.2025, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore bashkëpronarëve Xhevdet Krasniqi dhe Shqipe Jashari Krasniqi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr.350/02-169159/24 dt.24.12.2024, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore/shtëpisë familjare me etazhitet B+P+1, në kuadër të bllokut urban “F-03”, të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.816-0 ZK Sofali.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-247790 dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “*Banim individual i ulët*”.

Për kriteret urbane, parametrat dhe kushtet e ndërtimit sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, pronari është informuar përmes shkresës “Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm Sofalia 2016-2024”, me referencë 05-350/01-136336/24 dt.17.10.2024. të datës 18.10.2024, dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës;

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
- nr.816-0, meS=487m², me bashkëpronar Xhevdet Krasniqi dhe Shqipe Jashari Krasniqi,... “Arë e klasës 5”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në gjendjen faktike dhe incizimin gjeodezik të lokacionit, në kuadër të parcelës kadastrale të trajtuar, nuk ka ndërtim;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj;
- Terreni është i relativisht i rrafshët;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale është përmes rr.“Ksamili”, rrugë ekzistuese dhe njëherit e planifikuar;
- Parcela kadastrale e lartcekur shtrihet në bllokun urban “F-03”;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore, dhe ndërtesa tjera kryesisht ndërtime të ulta;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e shtëpisë individuale e banimore/shtëpisë familjare, në kuadër të bllokut urban “F-03”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet

tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik si dhe në bazë të 'Situacionit' të parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese në sistemin koordinativ KOSOVAREF01", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

- Destinimi i shfrytëzimit, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", është e planifikuar me destinim "Banim individual", me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira për parking, etj. (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas planit rregullues, është P+2, kurse i propozuar dhe i miratuar është B+P+1;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale nr.816-0 ZK Sofali, planifikohet ndërtimi i shtëpisë individuale banimore-shtëpisë familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim;
 - Sipërfaqe ndërtimore nëntokësore, $S=121.77 \text{ m}^2$
 $\text{Bodrumi} / S = 121.77 \text{ m}^2$
 - Sipërfaqe ndërtimore mbitokësore, $S = 281.14 \text{ m}^2$
 $\text{Përdhesa} / S = 139.10 \text{ m}^2$
 $\text{Kati i I-rë} / S = 142.04 \text{ m}^2$
 - Sipërfaqe totale ndërtimore, $S = 402.91 \text{ m}^2$
 - Etazhitet; **B+P+1**
- Pjesa e parcelës kadastrale nr.816-0 ZK Sofali me sipërfaqe totale të parcelës me $S=487 \text{ m}^2$, e trajtuar me sipërfaqe brenda vijës rregulluese–parcelës ndërtimore është $S=464 \text{ m}^2$, dhe $S=23 \text{ m}^2$ jashtë vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, sipas kushteve ndërtimore dhe Planit të situacionit–"zgjidhja urbane";
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhesës ose suterren, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", është max. 30%;
 - $S = 464 \text{ m}^2 \times 0.3 \text{ (30\%)} = 139.20 \text{ m}^2$;
 - $S = 139.10 \text{ m}^2 / 30 \text{ \%, sipas projekt propozimit}$;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", është max. 50%, ndërsa pjesa e bodrumit që del jashtë gabaritit të objektit në përdhesë nuk duhet të jetë mbi nivelin e tokës", është max 0.5 (50%);
 - $S = 464 \text{ m}^2 \times 0.5 \text{ (50\%)} = 232.00 \text{ m}^2$;
 - $S = 121.77 \text{ m}^2 / 26\%, \text{ sipas projekt propozimit}$;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese – (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, është min. 50%;
 - $S = 464 \text{ m}^2 \times 0.5 \text{ (50\%)} = 232.00 \text{ m}^2$;
 - $S = 232.00 \text{ m}^2 / 50.00\%, \text{ sipas projekt propozimit}$;
- Koeficienti i shfrytëzimit të sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore (ISPN) sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", është 0.8 (80%). Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese - parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë - suterren, dhe 0% për etazhet e nëntokës - bodrume.
 - $S = 464 \text{ m}^2 \times 0.8 \text{ (80\%)} = 371.20 \text{ m}^2$;
 - $S = 281.14 \text{ m}^2 / 61\% \text{ sipas projekt propozimit}$;
- Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës, për kthina primare min 0.5H, për kthina sekondare min 0.2H, dhe marrëveshja me fqinjtë deri në bashkim të plotë;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Kati përdhesë i ndërtesës, për tu konsideruar kat i plotë, duhet të jetë së paku 1.4m mbi sipërfaqen tokësore, duhet të ketë së paku 2/3 të sipërfaqes së vet në lartësi minimale prej 2.3m;
- Qasja në parcelë është përmes rrugës ekzistuese rr."Ksamili", në gjendje faktike rrugë dhe njëherit edhe e planifikuar sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024";
- Për shtëpi individuale banimi duhet të sigurohet 1 vendparking, për njësi banimi, vendiparkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 50 % për gjelbërim;

- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efikasitetit të energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.
- Të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, si dhe me normat dhe standardet tjera të planifikimit.

V. Ndarja/parcelimi i parcelës kadastrale nr. 816-0 ZK Sofali, do të realizohet sipas Situacionit të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore, Planit të situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - “zgjidhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçe në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçe nga “Termokos” - Ngrohja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m², me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale - kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdheshë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdheshë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;

- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr.816-0 ZK Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, "arë e klasës 5", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – "zgjidhjes urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S = 464m^2$, procedurë kjo e cila duhet të përfundohet pas realizimit të pikës V të këtij Vendimi. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës", 01nr.43/01-94474/17 dt. 24.04.2017, dhe "Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesit/bashkëpronarët Xhevdet Krasniqi dhe Shqipe Jashari Krasniqi nga Prishtina, me kërkesën 05 nr.350/02-169159/24 dt.24.12.2024, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit të Komunës së Prishtinës, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit/shtëpisë familjare, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr.350/02-169159/24 dt.24.12.2024, aplikuesi ka prezentuar këtë dokumentacion:

- Dëshminë mbi pronësinë/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën nr.816-0, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914066-00816-0 ZK Sofali, në emër të Xhevdet (Adem) Krasniqi dhe Shqipe (Adem) Jashari Krasniqi, të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;
- Kopje të dokumentit të identifikimit të bashkëpronarit Xhevdet Krasniqi;
- Kopje të dokumentit të identifikimit të bashkëpronarit Shqipe Jashari Krasniqi;
- Shkresën Informatën nga Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", me Ref.nr.04-350/01-136336/24 dt.17.10.2024, të lëshuar me datë 18.10.2024 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës;
- Incizimi gjeodezik për parcelën kadastrale nr.816-0 ZK Sofali, i punuar nga kompania gjeodeete e licencuar "Geo-Group" sh.p.k me nr. të licencës 47, si dhe kopjen e dokumentit të identifikimit të gjeodetit.
- Manuali gjeodezik për parcelën kadastrale nr.816-0 ZK Sofali, me ndarje, i punuar nga kompania gjeodeete e licencuar "Geo-Group" sh.p.k me nr. të licencës 47;
- Fotografi nga gjendja ekzistuese e terreni.
- Deklaratë-Pëlqim sipas të cilit pronar i parcelës nr.817-0 ZK Sofali jep pëlqimin që fqinjët e tij Xhevdet Krasniqi dhe Shqipe Jashari Krasniqi në parcelën e tyre nr.816-6 e që kufizohet me parcelën me nr.817-0, nuk do të i pengoj ndërtimi i shtëpisë së banimit asaj si fqinje, nuk e pengon edhe distanca deri në:100cm e afërsisë nga kufiri kadastral i parcelës, e po ashtu nuk i pengon edhe vendosja e dritareve të ndricimit, i përpiluar dhe vërtetuar te noteri Astrit S.Bibaj me LRP nr. 2745/2025 dt.27.05.2025;
- Një kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit konceptual të ndërtesës shtëpisë individuale të banimit/shtëpisë familjare, në kopje të fortë/fizike, me kopje digjitale në CD (Formati pdf), të hartuar nga kompania projektuese "CENTIMETRI" SH.P.K. me seli në Mitrovicë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.810177396;

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr.350/02-169159/24 dt.24.12.2024, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni - Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, ka konstatuar se parcela kadastrale nr.816-0 ZK Sofali, shtrihet në kuadër të bllokut urban "F-03", të tërësisë urbane "F", të "Plani Rregullues i Hollësishëm Sofalia 2016-2024", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-247790 dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim "Banim individual i ulët";

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 08.05.2025 ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m, për të njoftuar publikun me synimin e pronarit dhe investitorit, për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 12.05.2025, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të saj, bazuar në analizën urb-arkitektonike - të Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", dhe projektit konceptual - "Situacionit", kjo drejtori ka konstatuar se ka mangësi në dokumentacionin e prezantuar, andaj përmes shkresës zyrtare "Plotësim dokumentacioni", me 05 nr.350/02-169159/24 dt.24.12.2024, të datës 06.03.2025, ka kërkuar nga aplikuesi që t'i prezantojë *Projekti konceptual mund të prezantohet dhe të trajtohet vetëm për sipërfaqen e cila shtrihet brenda visë rregulluese/parcelës ndërtimore të paraparë me Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", 2016-2024*; *Projekti konceptual të ndryshohet dhe plotësohet duke rrespektuar kriteret e përcaktuara me Planin Rregullues të Hollësishëm "Sofali" 2016-2024, konkretisht të respektohen distancat: distanca e vendosjes së ndërtesës ndaj kufirit të parcelës, për kthina primare min 0.5 H, për kthina sekondare min.0.2 H, dhe marrveshja me fqinjtë deri në bashkim të plotë; Në rast të riparcelimit, të prezantoni propozim manualin për bashkimin e këtyre parcelave, si dhe për ndarje të tyre në vijë rregulluese, në mënyrë që të formohet parcela ndërtimore, të punuar nga gjeodeti i licencuar*;

Aplikuesi me shkresën zyrtare “Plotësim Dokumentacioni” me 05 nr.070/01-41758/25 dt.25.03.2025 i ka prezantuar kësaj drejtorie, manualin e ndarjes së parcelës kadastrale nr.816-0 ZK Sofali, punuar nga gjeodeti i licencuar, projektin konceptual sipas planit të situacionit - “zgjidhja urbane”, distancat e vendosjes së ndërtesës ndaj kufirit të parcelave fqinje, harmonizimin e koeficientit të shfrytëzimit të parcelës ndërtimore - (ISHP), andaj kjo drejtori ka vazhduar me procedurën për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesës në caktimin e kushteve ndërtimore për parcelën kadastrale nr.816-0 ZK Sofali, duke konstatuar se janë plotësuar të gjitha kriteret urbane të përcaktuar në Planin Rregullues i Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”.

Bazuar në aktin noterial “Deklaratë-Pëlqim”, të pronarit të parcelës kadastrale nr.817-0 ZK Sofali, është lejuar pozicionimi/ndërtimi i ndërtesës së planifikuar, përkatësisht pozicionimi i gabaritit në distancë prej 100 cm, citojmë “Këtë pëlqim e jap që fqinjët e mi Xhevdet Krasniqi dhe Shqipe Jashari Krasniqi në parcelën e tyre me nr.816-0, e që kufizohet me parcelën me nr.817-0, nuk do të më pengoj ndërtimi i shtëpisë së banimit mua si fqinje, nuk më pengon edhe distanca deri në:100cm e afërsisë nga kufiri kadastral i parcelës, e po ashtu nuk më pengon edhe vendosja e dritareve të ndricimit”, i përpiluar dhe vërtetuar te noteri Astrit S.Bibaj me LRP nr. 2745/2025 dt.27.05.2025.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të parcelës në rrugën ekzistuese të lagjes, dhe është konstatuar, si në vijim:

“Pas shqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Xhevdet Krasniqi dhe Shqipe Jashari Krasniqi, në Sofali, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-169159/24 dt.24.12.2024, kyçja për automjete në rrugën e cila është e paraparë me planin rregullues “Sofalia”, për ndërtesën shtëpi individuale me etazhitet B+P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës së planifikuar ne raport me parcelën 00816-0, Zk. Sofali. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës së planifikuar, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes, dhe në kohën kur rruga realizohet sipas planit.”

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit ka konstatuar se kërkuuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plan i Situacionit – zgjidhja urbane dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Planin Rregullues në sistemin koordinativ Kosovaref01” të punuar nga kjo Drejtori.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve, në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-169159/24 dt.24.12.2024, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 350/02-169159/24 Dt. 09.06.2025

Zyrtare,
Leonora Mehmeti



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo


Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01

ZK. Sofali




Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi : _____

Prishtinë: 19.05.2025

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- .-.-.-.- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcela Kadastrale



Kati	m ²
Bodrumi	121.77
Përdhësa	139.1
Kati	142.04
Total nën tokë	121.77
Total mbi tokë	281.14
Total objekti	402.91

Parcela	B.V Rregulluese	J.V Rregulluese	ISHP	ISPN	ISN	ISGJ
487.0	463.66	23.34	139.1	370.9	231.8	231.8

Vija Rregulluese
Vija Ndërtimore
Vija e Parcelës
Kontura e Përdhësës
Hyrjet

cm
CENTIMETRI
byro e arkitekturës

planifikojmë çdo centimetër të hapësirës suaj...
"CENTIMETRI" SH.P.K.
NRB. 70305690
Tel: +38349214020, centimetrishpk@gmail.com
Office 1: Rr. Kosta Novakoviç, Lagjia Pejlon Pr.
Koment i rëndësishëm:
Me ligjet në fuqi ndalohej kopjimi, shfrytëzimi apo
qarndo forme e përhapjes-shpërndarjes së projektit.
Të drejtat ekskluzive CENTIMETRI SH.P.K.
IMPORTANT INFORMATION:
Copyright - this drawing is the property of Ylli
SHAQIRI, Architect, A/0041. Any use without the
expressed written consent of Ylli SHAQIRI/0041,
Architect, is prohibited.

VEREJTJE
- Dimensionet të verifikohen në teren. Vetëm dimensionet
e theksuara të përdoren dhe çdo mospërputhje në
dimensione të raportohet të administruesit të kontratës.
Asnjë dimension të mos matet nga vizatimi i shtypur.
Të gjitha pjesët e paraqitura në këtë vizatim janë vetëm
për udhëzim. Nuk merret përgjegjësi për saktësinë e tyre.
- Masat në punishtë të verifikohen nga punëkryesit në
ditarin ndërtimor, nëse ka ndonjë pakartësi-ndryshim të
raportojnë të mbikëqyresit dhe arkitektit.
Në rast të mos korespondimit me fazat tjera duhet të
konsultohet kontrolluesi i projektit (shih tabelën).
- Punët duhet të planifikohen në detaje dhe çdo punonjës
duhet të pajiset me të gjitha masat mbrojtëse për atë
punë. Çdo grup punues duhet të bëjë vlerësimin e
rreziqeve të punës dhe konform rrezikut të jetë i
përgaditur si psikologjikisht ashtu edhe fizikisht me të gjitha masat
mbrojtëse.
- Cimet e produkteve janë referuese, cimet finale
definohej nga momenti i gjendjes se tregut kur behet
porosia.
- Së fundi përgjegjësi e jona është që të plotësohen
kërkesat e klientit pavarësisht nëse ato refuzohen nga
palët e treta si komuna, ministria etj.
Suksese në punë!

Koment:

Objekti
**SHTËPI BANIMI
B+P+I**

Investitori
Xhevdet Krasniqi

Prezentohet
Situacioni i Ngushtë

Faza Planifikuese
FAZA PLANIFIKUSE / PROJEKTI IDEOR

Projektuar nga:
MSc. Arch. Ylli SHAQIRI
Date:
5/15/2025

Kontrolluar nga:
Arch. Gani RËTKODERI
Date:
5/15/2025

Koment:
Fleta
Nr. 03
Perpleksi
1:150
1:1.38
Nr. Zonë kadastrale

SH.P.K.
PRISHTINE
CENTIMETRI